



Datë: 06.10.2025
Numër Protokolli: 6642/2025

A.nr.1088/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Hava Fekaj-Zyrtare e Lartë për Inspektim Administrativ, në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas ankesës më numër A.nr.1088/2025, të datës 27.07.2025, të parashtruar nga ankuesja L.S, në çështjen juridike “Kontestim Konkursi”, bazuar në nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 06.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës A.nr.1088/2025, të datës 09.06.2025, të parashtruar nga ankuesja L.S.

A r s y e t i m

Ankuesja L.S, (tutje referuar: ankuesja), më datë 09.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 24.04.2025, të Menaxheres së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural lidhur me refuzimin e aplikacionit në procedurën e pranimi me numër reference RN000108370, për Grupin e Shkencave Shoqërore, pozita Zyrtar i Lartë Ekzekutiv, i shpallur nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa, e njëjta më datë 06.10.2025, përmes e-mailit zyrtar (ankesa.kpmschck@rks-gov.net), ka parashtruar kërkesë për tërheqje të ankesës me numër A.nr.1088/2025 të datës 09.06.2025, me arsyetimin se tërheqjen e ankesës e bënë për arsye personale.

Kolegji i Këshillit duke marr për bazë kërkesën e datës 06.10.2025 të ankueses, konstatoi plotësimin e kushtit ligjor për përfundimin e procedimit administrativ, siç parashihet me dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”, dhe si rrjedhojë në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi për përfundimin e procedimit administrative të filluar sipas ankesës A.nr.1088/2025, të datës 09.06.2025.

Këshillë juridike: Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1088/2025

Hava FEKAJ

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses L.S;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në MBPZHR-sw;
- Arkivit të KPMSHCK-së